



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT
KORÇË

KESHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM
Nr. 34 Date 02.01.2009

Për miratimin e vlerës për kryerjen e pagesës së 2%, për investimet e Bashkisë.

Këshilli I Bashkisë në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit Planifikimit Urban të Territorit dhe Drejtoria e Financës, mbështetur në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e çeverisjes vendore" neni 32 pika dh, në ligjin "Për Urbanistikën" Nr. 8405 datë 17.09.1998, ndryshuar me ligjin Nr.8501, datë 16.06.1999, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", Neni 2, në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" neni 27, pika 2, në ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin Nr.10025 datë 27.11.2008, "Për buxhetin e vitit 2009", në udhëzimin e MF Nr. 2 datë 12.01.2009 "Për zbatimin e buxhetit të vitin 2009" si dhe në VKB Nr. 12 datë 13.02.2009 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2009" vendor."

VENDOSI :

1. Të miratojë vlerën e pagesës së tarifës së 2 % për objektet që janë në ndërtim dhe nuk ju është zbardhur Leja e ndërtimit si më poshtë:
 - Ndërtim shkollë 9-vjeçare , Lagja e Re Sporti, me vlerë investimi 73 906 762 lekë dhe vlera e taksave për tu paguar 1 478 136 lekë
 - Rikonsrtuksion dhe shtesë në shkolla 9-vjeçare "Sevasi Qirjazi", me vlerë investimi 50 029 828 lekë dhe vlera e taksave për tu paguar 1 000 596 lekë

- Banesat me kosto të ulët për komunitetin Rom, në afërsi të ish Traverbangut me vlerë 17 758 234 lekë dhe vlera e taksës për tu paguar 355 200 lekë.

Gjithashtu edhe për banesat me kosto të ulët që janë miratuar për tu ndërtuar, pagesat e taksave në bazë të marrëveshjeve të lidhura nga Bashkia do të paguhen po nga Bashkia si pjesë e investimit të saj, si më poshtë:

- Banesa me kosto të ulët që do të ndërtohet nga Enti I Banesave, tek rruga "Petro Sturgji" (pjesë e unazës), me vlerë të përafërt investimi 85 000 000 lekë dhe vlera e taksave për tu paguar 1 700 000 lekë.
- Banesat me kosto të ulët (Banesat Sociale me Qira), tek ish Reparti 741, Lagja e Re Sporti, me vlerë të përafërt investimi 170 920 960 lekë dhe vlera e taksave për tu paguar 3 418 420 lekë.

Pra, buxheti i Bashkisë për vitin 2009 do të rritet në 7 952 352 lekë dhe po kjo vlerë do të kalojë për pagesën e 2% të detajuar si më sipër.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Raimonda NASE

Raimonda Nase
KRYETARE